

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Reagimi - Anulohet tenderi 50 mln euro për hemodializën/ Spahia: MSH të bëjë transparencë! Cilat ishin 'gabimet e rëndësishme'?
ADRESA	https://www.syri.net/politike/919319/anulohet-tenderi-50-mln-euro-per-hemodializen-spahia-msh-te-beje-transparence-cilat-ishin-gabimet-e-rendesishme/
BURIMI	syri.net
GJENDJA	unreachable

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 11:59:14 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 11:51:07 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	d3aee0d6c061d67a4263ff4cb22621c325146de9fa81a55e49bc3a50f413f224
TEKSTI	ff98867b19d97966882a4725002f014bfd8a3bb21041b6ee4ea81307eb39de07
PAMJA	0dc749b25a001a52ad69cf7559b88ca833c11d3154de35c795b3d5f048614e69

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	52dc8ea04a6f4337d7830577ffbfb841e35d0e7e495a18c7d0853843103ed43d
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0248b36ffa7147e2cf97c5d4334b4ac10f1e643fb19828b3303283d4e0ef69ec
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/52dc8ea04a6f4337d7830577ffbfb841e35d0e7e495a18c7d0853843103ed43d>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

**NDRIÇIM KULLA**
Dorëheqja e Ramës, kërkesë
edhe e ndërkombëtarëve**ENVER BYTYÇI**
Vendimi i Hagës dhe raporti
ynë me të vërtetën!

më të lexuarat

'Iu hoq cipa e maskës mazhorancës',
Goxhaj: Po i vjen fundi kësaj kaste,
Rama s' menaxhon dot më

VIDEO/ Balliu: A ka folur Edi Rama me
Ergys Agasin përmes telefonit të Vlorë
Hysenit?

Mashtrimi me shëndetësinë falas:
Shqipëria e dyta në Europë për koston e
lartë

Berisha: Foltoret e Ripërtërimit në Vlorë
dhe Elbasan dëshmuar se orteku i
opozitës po rritet çdo ditë

Akuzat ndaj shefes së SHISH vënë në
pikëpyetje sigurinë kombëtare të
Shqipërisë

'Garancia e plotë' e Ramës dhe
përgjegjësia e tij politike për Vlorë
Hysenit

Anulohet tenderi 50 mln euro për hemodializën/ Spahia: MSH të bëjë transparencë! Cilat ishin 'gabimet e rëndësishme'?

13:51, 26/09/2026

ZMADHO TEKSTIN



Kryetari i Komisionit të Shëndetësisë, njëkohësisht dhe deputeti i PD, Bardh Spahia, kërkon transparencë nga ministrja e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu, për anulimin e tenderit rreth 50 milionë euro për shërbimin e hemodializës.

Spahia thekson se tenderi kishte vetëm një ofertues, Diaverum AB, e shpallur fituese më 10 shtator me një ofertë prej 4.44 miliardë lekësh pa TVSH, ndërsa me pas procedura u anulua për shkak të gabimeve ose mangësive të rëndësishme.

Ai kërkon të bëhen publike mangësitë konkrete, përfundimet e auditimit dhe përgjegjësit për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Reagimi i plotë:

Ministrja e Shëndetësisë, Klodiana Spahiu, duhet të bëjë transparencë të plotë për anulimin e tenderit të hemodializës me vlerën prej 50 milionë euro. Kjo procedurë, që lidhet me një shërbim jetik për pacientët në pesë spitale rajonale, u zhvillua me vetëm një ofertues. Më 10 shtator u shpall fituese Diaverum AB, me një ofertë prej 4,44 miliardë lekësh pa TVSH. Më pas procedura u anulua, ndërsa shpjegimi i publikuar kufizohet te konstatimi se dokumentet e tenderit përmbanin «gabime ose mangësi të rëndësishme».

Në interpelancën e seancës së 17 shtatorit, pyetjeve të ngritura nga ana ime, ministrja ju përgjigj duke thënë se do të priste përfundimet e auditimit për të marrë vendimet e duhura. Më shumë se një javë më pas, publiku ende pret të mësojë cilat ishin gabimet apo shkeljet, kush i miratoi dokumentet dhe çfarë ka konstatuar auditimi, e kujt është përgjegjësia?

Nuk mundet t'u hidhet hi syve shqiptarëve me një justifikim kaq të përgjithshëm për anulimin e tenderit që kushton dhjetëra miliona euro nga taksat e tyre dhe ka një rëndësi jetike për mijëra të tjerë.

Zonja Ministre, ju duhet të sqaroni publikisht se si u përgatit dhe u mbyll një procedurë prej rreth 50 milionë eurosh, si u shpall fitues operatori, i vetëm pjesëmarrës dhe vetëm më pas u zbuluan mangësi kaq të rëndësishme sa të kërkonin anulimin?

Cilat janë konkretisht këto mangësi dhe në cilën fazë duhej të ishin konstatuar ato?

A ishte anulimi pasojë e një kontrolli të dokumentuar apo në fakt ai synon rihapjen e një procedure të re për të ndryshuar operatorin fitues?

Kush mban përgjegjësi për hartimin dhe miratimin e dokumenteve: drejtuesit e autoritetit kontraktor, përfshirë drejtoreshën që larguat nga detyra vetëm një ditë pasi erdhët në drejtimin e Ministrisë, apo do t'ia faturoni ndonjë zyrtari të thjeshtë?

A është anulimi i tenderit një fakt, një justifikim sepse qëllimi është për t'ia kaluar një operatori tjetër ekonomik të lidhur me Sani Sanilevich, miku i Roni Yeffet dhe Edi Ramës?

Zonja Ministre, ju keni detyrimin t'i bëni publike vendimin e arsyetuar të anulimit, dokumentet ku janë identifikuar gabimet, përgjegjësit për to, përfundimet e auditimit dhe planin që garanton vazhdimësinë e hemodializës për pacientët.

Qytetarët kanë të drejtë të dinë çfarë ndodhi me këtë tender dhe kush do të mbajë përgjegjësi.

Heshtja tregon se ju po i shërbeni vetëm një agjende, shndërrimin e Shëndetësisë nën modelin KAYO në dorë të interesave okulte dhe personale të Edi Ramës.

© SYRI.net

Lexo edhe:



Berisha: Nga çdo demokrat kërkohet mobilizimi më i madh për një rezultat të shkëlqyer në zgjedhjet e ardhshme



A do organizojë opozita protestë kombëtare? Berisha: Do ta njoftojmë, koha ka ardhur dhe ka kaluar



Mbledhja e Këshillit të Sigurisë Kombëtare/ Berisha: Nuk kam marrë asnjë ftesë

Fjalimi i turpshëm në OKB/ Berisha: Rama, armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër VV-së

'Zullumi po e kap për fyti Ramën', Noka në Tepelenë: Skandalet e kanë zhveshur totalisht

Berisha: Rama kërkon t'i paraqesë shqiptarët si antisemitë, terroristë e çdo gjë tjetër vetëm që të qëndrojë në pushtet

TË NGJASHME



Berisha: Duhet të bëjmë gjithçka që Rama të shkojë në bankën e akuzës ku e ka vendin



Investimet nga fonde konfidenciale/ Berisha: Do të kërkojmë në Kuvend transparencë të plotë



Berisha: Komuniteti ndërkombëtar gjithnjë e më shumë po mëson të vërtetën e padrinos Edi Rama



Berisha i uron mirëseardhjen ambasadorit të ri: SHBA do japë ndihmë substanciale për çmontimin e narkoshtetit



Berisha: Provat direkte më të mëdha i kam për Edi Ramën, por SPAK nuk guxon ta thërrasë



Berisha: Sulmi i Ramës ndaj Joe Biden për dënimin e Thaçit është një paturpësi ekstreme




Berisha: Rama kërkon t'i paraqesë shqiptarët si antisemitë, terroristë e çdo gjë tjetër vetëm që të qëndrojë në pushtet

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË/STIL TRASHËGIMI MJEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do t'i gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojme të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Staf i SYRI.net

Për informacione info@syri.net, për reklama marketing@syri.net



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.